



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 86
Prishtinë, më 15 nëntor 2012

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 15 NËNTOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare dhe procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Xhevahire Izmaku, Vjosa Osmani, Visar Ymeri, Aurora Bakalli, Goran Marinković, Halit Krasniqi, Afrim Kasolli, Mursel Halili, Bekim Haxhiu, Fadil Demaku dhe ministri Bajram Rexhepi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit Agim Çeku në lidhje me gradimin e femrave me gradën e gjeneralit në Forcën e Sigurisë së Kosovës.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Musliu.

Deputetja Ganimete Musliu i parashtrroi pyetje ministrit Nenad Rashiq në lidhje me punësimin e personave me aftësi të veçanta.

Ministri Nenad Rashiq iu përgjigj pyetjes së deputetes Musliu.

Deputetja Time Kadrijaj i parashtrroi pyetje ministrit Agim Çeku në lidhje me kriteret e caktuara nga Komisioni qeveritar për verifikimin e saktë të numrit të veteranëve të UÇK-së.

Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadrijaj.

Deputetja Sala Berisha-Shala i parashtrroi pyetje ministrit Ramë Buja në lidhje me studimet pesëvjeçare të fushave të ndryshme teknike për të fituar tituj master.

Ministri Ramë Buja iu përgjigj pyetjes së deputetes Berisha-Shala.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 8 nëntor 2012.

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013

Kryesuesi e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë së Kosovës që ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Ministri i Financave, **Bedri Hamza**, në emër të Qeverisë së Kosovës tha se procesi buxhetor ka filluar në fillim të vitit 2012, me nxjerrjen e indikatorëve të hershëm makroekonomikë, si dhe deklaratës së prioritetëve nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Gjatë këtij procesi ne kemi pasur takime të rregullta me të gjitha organizatat buxhetore, i kemi diskutuar projektet në nivel të programeve, përkatësisht projektet specifike, gjithmonë duke i pasur në konsideratë resurset e mundshme për financim.

Projektbuxheti është diskutuar dhe është në harmoni të plotë me Fondin Monetar Ndërkombëtar.

Në Projektbuxhetin për buxhetin për vitin 2013 kemi pasur në konsideratë prioritetet e Qeverisë, siç është rritja ekonomike.

Rritja ekonomike në Kosovë për vitin 2013 vlerësohet që të jetë 4,5%, duke i marrë parasysh ecuritë që janë të pranishme në eurozonë.

Treguesit kryesorë të kësaj rritjeje ekonomike është konsumi agregat për vitin 2013 dhe dy vjetët në vijim pritet të ketë një rritje mesatare prej 6,2%, ndërsa, vetëm konsumi privat pritet të ketë një rritje më të lartë mesatare prej 6,9%, në vitin 2013, 5,2%. Investimet private, si një komponentë shumë e rëndësishme e rritjes ekonomike, pritet që gjatë tre vjetëve të ardhshme të rriten me një normë mesatare prej 7,8%, në vitin 2013 9,1%.

Eksportet totale në vitin 2013 pritet ta kenë një rritje prej rreth 11,5%, ndërsa vetëm eksportet e mallrave vlerësohet se do të kenë një rritje mbi 18%.

Për vitin e ardhshëm projeksionet tona tregojnë se do të kemi një ngritje modeste të çmimeve, që vlerësohet se inflacioni për vitin 2013 do të jetë në nivel 1,5%.

Dërgesat e qytetarëve, si një element i rëndësishëm i financimit të konsumit të investimeve, pritet që të kenë trend stabil.

Veçori kryesore e këtij buxheti është se vazhdon trendi i rritjes nga viti në vit edhe në pjesën e të hyrave dhe në pjesën e shpenzimeve.

Të hyrat në vitin 2013, në krahasim me vitin aktual, në total planifikohet të ketë një rritje prej 3%. Të hyrat vendore nga tatimet, taksat, doganat, do të kenë një rritje prej 5%, ndërsa rritjen më të madhe do ta kenë të hyrat vetjake të nivelit qendror dhe lokal, që do të kenë një rritje prej 22%.

Shpenzimet do të jenë më të larta për 4%, në lartësi 1 miliard e 586 milionë. Të gjitha kategoritë e shpenzimeve e kanë një rritje. Po ashtu, rritje ka edhe kategoria e shpenzimeve për paga dhe mëditje.

Kemi rritje edhe te pozicioni i mallrave dhe shërbimeve për 10%, në krahasim me vitin aktual.

Kemi zvogëlim të subvencioneve për ndërmarrjet publike, ndërsa në total kemi rritje të këtij pozicioni. Me këtë projektbuxhet sigurohen mjete të mjaftueshme për përfundimin e projektit të Rugës së Kombit “Ibrahim Rugova”, sipas kontratës dhe për fillimin e autostradës së re prej Prishtinës deri në Han të Elezit. Mundësohet vazhdimi i punimeve në rrugën Prishtinë-Pejë, Prishtinë-Mitrovicë dhe shumë rrugëve tjera me karakter lokal dhe rajonal.

Është arritur që të garantohet dhe të ruhet stabiliteti makrofiskal, deficitin primar gjatë periudhës së kaluar ka qenë 1,5%, deficitin i përgjithshëm 1,8% dhe ky projektbuxhet i reflekton prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Buxheti është i bazuar në burime të qëndrueshme, në projektbuxhet është e paraparë edhe e hyra nga financimi i njëhershëm, mirëpo të gjitha projektet brenda buxhetit janë të lidhura me të hyrat e rregullta.

Burimet për financimin e buxhetit janë më se të mjaftueshme për financimin e të gjitha projekteve që janë pjesë e buxhetit.

Pas paraqitjes së Projektbuxhetit nga ministri Hamza, kryesuesi e hapi diskutimin.

Për Projektbuxhetin e Kosovës për vitin 2013 diskutuan:

Safete Hadërgjonaj, në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, tha se Komisioni në mbledhjen e mbajtur më 7 nëntor 2012 e ka shqyrtuar Projektligjin për buxhetin për vitin 2013 dhe ka vlerësuar se projektligji është përgatitur teknikisht mirë dhe është brenda afateve, të cilat i parasheh korniza ligjore.

Komisioni e ka miratuar në parim Projektligjin për buxhetin për vitin 2013 dhe ka rekomanduar që buxheti të miratohet në seancë plenare që t'i krijohet mundësia Komisionit që të bëjë plotësim-ndryshimet e duhura para shqyrtimi të dytë të projektligjit.

Projektbuxheti e ruan qëndrueshmërinë fiskale në sajë të një planifikimi të matur që u janë bërë shpenzimeve për vitin 2013, në raport me të hyrat e parashikuara. Është bërë një shpërndarje efikase e tyre nëpër kategori të caktuara, që mundëson realizimin e projekteve të rëndësishme kapitale dhe siguron një ambient të favorshëm për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik.

Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ky projektbuxhet është dëshmia më e mirë se Qeveria e Republikës së Kosovës është në shërbim të të gjithë qytetarëve të Kosovës dhe interesave të tyre. Është një rezultat i punës dhe përpjekjeve të institucioneve të vendit për ta hartuar një buxhet, i cili garanton zhvillim ekonomik dhe përmirësimin e vazhdueshëm të mirëqenies së qytetarëve të vendit tonë. Me gjithë vështirësitë ekonomike nëpër të cilat po kalon jo vetëm Kosova dhe vendet e rajonit, por edhe vendet e tjera të zhvilluara të Evropës, me këtë projektbuxhet Qeveria e Republikës së Kosovës, me politikat e saj shtet-formuese vazhdon ta ruajë qëndrueshmërinë makrofiskale dhe stabilitetin makrofiskal.

Duke i pasur parasysh se prioritet janë interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës, grupi ynë parlamentar është për miratimin e këtij projektbuxheti.

Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, tha se ky projektbuxhet i mbyt shpresat e qytetarëve të Kosovës për jetë më të mirë, i falimenton bizneset vendore dhe e çon edhe më tej në kolaps ekonominë e Kosovës. Nuk është buxhet i zhvillimit, pasi nuk mbështetet në asnjë objektiv zhvillimor, sepse kjo Qeveri nuk ka plan zhvillimor. Parashikimet për rritje ekonomike kanë rënë nga 8% në 4,5%, ndërsa zvogëlimi i papunësisë, i paraparë prej 8 deri në 10% mbetet thjesht një mashtrim i opinionit.

Rritja e deficitit tregtar nga viti në vit po i vë në pikëpyetje të gjitha skenarët për rritje ekonomike. Ekonomia e Kosovës po shndërrohet në një ekonomi konsumuese, e varur nga importet, të cilat paguhen kryesisht nga remitencat e bashkatdhetarëve tanë.

Grupi Parlamentar i LDK-së nuk mund ta mbështesë këtë buxhet, pasi është në dëm të qytetarëve dhe bizneseve. Ne kërkojmë që të rishikohet shpërndarja e investimeve kapitale, sidomos në arsim dhe në infrastrukturë rrugore, dhe të shpërndahen drejt nëpër komunat, bazuar në formulat për shpërndarjen e grandeve nëpër komuna.

Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të “Vetëvendosjes”, tha se Projektbuxheti i vitit 2013 nuk ka kurrfarë dallimi thelbësor me atë të vitit 2012, por as edhe me vitet 2011, 2010, 2009. Është e njëjta logjikë e të buxhetuarit dhe të njëjtët sektorë ekonomikë vazhdojnë ta marrin pjesën më të madhe të parasë publike, pa kurrfarë planifikimi apo treguesi që këto do të ndikojnë në zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Edhe ky buxhet, sikur të tjerët para tij, në pjesën e të hyrave vazhdon të varet nga doganat, pra nga malli i importuar, shumë kjo që planifikohet të përbëjë diku 75% të të hyrave të përgjithshme të buxhetit.

Pra, ky është buxhet i cili nuk ka fare koncept të zhvillimit. Ky është një buxhet i asfaltit dhe betonit, e jo buxhet i investimeve në sektorët prodhues. Zhvillimi ekonomik i Kosovës vjen nga investimet në prodhim, nga hapja e vendeve të punës së bujqësi, në energji dhe në industri. Rritja ekonomike dhe mirëqenia e qytetarëve varen nga investimet në arsim dhe shëndetësi, në rritjen e kapaciteteve prodhuese që shtojnë vlerë dhe nga rritja e kualifikimit dhe frytdhënsshmërisë së fuqisë punëtore. Ky buxhet nuk e bën as për së afërmi këtë. Ky buxhet është në funksion të interesave afatshkurtra dhe të pushtetit, e jo në funksion të interesit afatgjatë për zhvillim.

Grupi Parlamentar i Lëvizjes “Vetëvendosje” nuk do ta votojë këtë buxhet.

Ardian Gjini, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, tha se në këtë projektbuxhet ka mospërputhje të shpeshta ndërmjet politikave që deklarohen dhe që janë publike, dhe asaj që shkruhet në tabelat e buxhetit.

Një prej problemeve të mëdha që shihet në këtë buxhet janë projektet e bartura. Projektet e reja ju thashë që janë jashtëzakonisht në numër të vogël, janë josinjifikante. Kemi 440 milionë përafërsisht mjete, të cilat shpenzohen për paga dhe mëditje dhe raporti.

Një element tjetër është përsëritja e projekteve dhe kjo ka të bëjë me vlerën e parasë së investuar dhe kjo përsëritje e projekteve është goxha e shpeshtë. Ka rrugë që ndërtohen tri herë, ndërtohen - shkatërrohen, ndërtohen - shkatërrohen.

Çështje tjetër që ka të bëjë me shpërputhjen është ndërmjet asaj që deklarohet për rritje ekonomike dhe rritjes së buxhetit, e sidomos kur e kemi parasysh që buxhetet e viteve të fundit marrin edhe hua, domethënë shteti merr hua, hua publike.

Grupi Parlamentar i AAK-së do ta votojë në lexim të parë këtë projektbuxhet, por e rezervon të drejtën të votojë kundër në lexim të dytë, nëse nuk do të bëhen ndryshime gjatë shqyrtimit në Komisionin Funkcional.

Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar Koalicioni për Kosovë të Re, tha se Projektbuxheti 2013 është projektbuxhet i mundësive, ku rritja ekonomike arrihet nga investimet kapitale dhe nga një pjesë e investimeve private.

Projektbuxheti është projektuar në bashkëpunim me Fondin Monetar Ndërkombëtar, duke e ruajtur qëndrueshmërinë makrofiskale për shtetin e Kosovës. Mbi këtë projektim parashihet niveli i përgjithshëm i grumbullimit të të hyrave buxhetore për vitin 2013, që është paraparë të jetë 1,423 milionë.

GP i Koalicionit për Kosovë të Re e përkrah Projektbuxhetin 2013.

Jelena Bontiq, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, tha se e kanë shqyrtuar Projektbuxhetin për vitin 2013 dha ai paraqet mundësitë e zhvillimit real dhe është i balancuar.

Ky projektbuxhet prej 1,58 miliardë euro bazohet në zhvillimin ekonomik të Kosovës dhe pjesa më e madhe tij prej 40 % është destinuar për investime kapitale.

Këtij projektbuxheti mund t'i bëhet vërejtje se nuk ka ndarë mjete të nevojshme për zhvillimin e bujqësisë, si një degë e zhvillimit ekonomik të vendit.

Me këtë projektbuxhet është dashur që investimet nga niveli qendror të barten në nivelin lokal, sidomos në komunat e reja, që janë krijuar me procesin e decentralizimit.

Me gjithë disa vërejtje, marrë në tërësi, Projektbuxheti për vitin 2013 është i mirë dhe duhet miratuar.

Duda Balje, në emër të Grupit Parlamentar “6+”, tha se Projektbuxheti për vitin 2013 është real dhe i shpërndarë sipas prioriteteve që ka planifikuar Qeveria e Kosovës për vitin e ardhshëm.

Grupi ynë parlamentar, gjatë fazës së shqyrtimit në Komisionin Funkcional do të kërkojë që me këtë buxhet të realizohen interesat e përgjithshme të vendit, por edhe të investohet për zhvillimin e infrastrukturës në mjediset ku jetojnë bashkësitë e komuniteteve joshumicë, si në komunën Prizren, Dragash, Pejë.

Qeveria duhet t'i mbajë sidomos premtimet e dhëna për investime në fshatin Restelicë, ku kishte ndodhur katastrofa natyrore.

Grupi Parlamentar "6+" e mbështet në parim Projektbuxhetin për vitin 2013.

Për Projektbuxhetin e vitit 2013 diskutuan edhe këta deputetë: **Daut Haradinaj, Hykmete Bajrami, Rexhep Selimi, Time Kadrijaj, Ismet Beqiri, Lumnije Morina, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Afërdita Berisha-Shaqiri, Bekim Haxhiu, Muhamet Mustafa, Ali Sadriu, Albulena Haxhiu, Emilija Rexhepi, Zenun Pajaziti, Lutfi Haziri, Alma Lama, Valbona Dibra, Arben Gashi, Afrim Kasolli, Jeton Svirca, Hamza Balje, Latif Gashi, Donika Kadaj-Bujupi, Sasha Milosavljeviq, Albert Kinolli, Salih Morina, Liburn Aliu, Imri Ahmeti, Shaip Muja, Ramë Vataj, Sevdije Lama, Albin Kurti, Nait Hasani, Sadri Ferati, Sala Berisha-Shala, Nijazi Idrizi, Lirije Kajtazi, Idriz Vehapi, Hashim Deshishku, Blerta Deliu-Kodra, Anton Quni, Ramiz Lladrovci, Teuta Haxhiu, Bahri Thaçi, Halit Krasniqi, Sali Asllanaj, Ganimete Musliu, Haki Demolli, Xhavit Haliti dhe Fadil Demaku**, si dhe ministrat **Fehmi Mujota dhe Nenad Rashiq**, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, ministri Bedri Hamza dha shpjegime në vërejtjet e deputetëve për Projektbuxhetin e viti 2013 dhe i ftoi ata që ta miratojnë projektligjin.

Në fund, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Rezultati i votimit ishte si vijon:

Për -----62,
Kundër -----31,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi me shumicë votash në parim Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL dhe raportues dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013 dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

Kryetari i mbylli punimet e mbledhjes plenare në orën 19:20 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale